

RIFINITURA



ÇIMENTO E BARDHË

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
E bardhë	Thes, 25 Kg	1.2-1.5 (kg/m ²)/mm trashësi

PËRSHKRIM

Çimento e bardhë CEM I 42.5R Çimento e bardhë e cilësisë së lartë . Për përgatitjen e betoneve, suvave mbushëse, nove, stukove dhe kollës së pllakave. Falë markës së lartë që ka (42.5), arrin të fitojë dhe një rezistencë të madhe mekanike në produktet e kombinuara. Për një suva mbushëse tradicionale përdoret në këto raporte: 100kg çimento : 300 kg rërë me granulometri (0.0-1.4) mm. Llaçrat me këtë çimento kanë aftësi të lartë për t'u lidhur me bazamentin, dhe veti të mira fleksibiliteti falë aftësisë së saj për t'u përshtatur ndaj lëvizjeve të bazamenteve, ndryshimeve termike dhe çedimeve të objekteve.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret si shtresë përfundimtare e cila duhet trajtuar me llak mbrojtës në shkallë, dysheme, mure dhe për struktura të veçanta si mure në banja, kolona të jashtme, etj.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Produkti mund të aplikohet në dy suporte:

1. Në beton të lëmuar ku paraprakisht bëhet astarimi me astar akrilik dhe aplikohet Çimento mbasi astari është tharë.
2. Në kartonxhes ku paraprakisht bëhet astarimi me astar akrilik, rrafshohet me bondex, mbas 24 orësh riastarohet dhe aplikohet Çimento.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

1 kg Çimento tretet në 24% ujë derisa të krijohet një përzierje uniforme. Produkti aplikohet duke përdorur mallë të lëmuar në trashësi 1-3 mm, në një ose dy shtresa. Mbas tharjes mund të fërkohet me letër zmerili në varësi me sa e lëmuar kërkohet të jetë sipërfaqja. 2-3 ditë mbas plotësimit të aplikimit, dhe me kusht që sipërfaqja është tharë, mund të aplikohen llaqet mbrojtëse.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Ujë për përzierjen: 24%
Paketimi: Thasë letre 25kg në paleta me 1350 kg	Trashësia e aplikimit: Nga 1-3mm
Ngjyra: E bardhë	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Përbërja: Çimento, inerte të seleksionuar, rezina, additive.	Koha e punushmërisë në kovë: 90 minuta
Konsumi: 1.6 kg/m ² /mm trashësi	Rezistenca në përkulje: ≥ 6.0 N/mm ²
Magazinimi: Të ruhet në vënde të thata mbi paleta druri	Densiteti i llaçit të thatë: 1.32 gr/cm ³
Koha e magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	Rezistenca në shtypje: 30 N/mm ²
Granulometria: 0.7mm	

